



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.19 datë 23.07.2014

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.1, DATË 26.02.2014, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2014-2016 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2014” NË KUADËR TË VIZITËS SË PAPA FRANÇESKUT NË MUAJIN SHTATOR NË TIRANË”.

Në mbështetje të nenit 19, pika 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar), vendimit nr.1, datë 26.02.2014 të Këshillit Bashkiak të Tiranës, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014 ”, Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 440 datë 2.7.2014 “Për Krijimin e Komisionit Shtetëror Për bashkërendimin e punës për organizimin e aktiviteteve lidhur me vizitën e Papa Franceskut në Shqipëri me datë 21.09.2014” , udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimit plotësues nr.3 datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, të shkresës nr 8 prot datë 11.7.2014 të Komisionit Shtetëror Për bashkërendimin e punës për organizimin e aktiviteteve lidhur me vizitën e Papa Franceskut në Shqipëri me datë 21.09.2014, Sekretariati Teknik, lënda “Dërgohen për zbatim vendimet e komisionit shtetëror”, me propozim të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në pikën 2.4 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.1, datë 26.02.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014 ”, detajuar sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi, me vlerën 332,786,906 Lekë, për projektin “Rivitalizimi i sheshit “Nënë Tereza”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

PASQYRA NR. 1
NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2014

në lekë

		Kosto e plotë	Plani 2014
	SHTESA	332,786,906	100,000,000
	Programi i Shërbimeve Publike Vendore		
I	Gr.00 Tit. 06260 Kap.5 Art 231	332,786,906	100,000,000
	Aparati i Bashkisë		
1	Projekti "Rivitalizimi i Sheshit Nënë Tereza"	332,786,906	100,000,000
	<i>Ndërtim-montim</i>	327,501,485	100,000,000
	<i>Mbikqyrje punimesh</i>	4,892,419	
	<i>Kolaudim</i>	393,002	
	PAKESIME		100,000,000
	Programi i Strehimit dhe Planifikimit të Territorit		50,000,000
I	Gr.00 Tit. 06140 Kap.5 Art 230		
a	Aparati i Bashkisë		
	Hartimi i Planeve te detajuara vendore		15,000,000
	Shpronësime per interes publik		
II	Gr.00 Tit. 06140 Kap.5 Art 231		
a	Aparati i Bashkisë		
	Sistemimi i rrugëve dhe lulishteve në të dy anët e rrugës në Kombinat		10,000,000
	Ndërtimi i Infrastrukturës në Bll. Nr.59,Rr. "A. Demi"		5,000,000
	Ndërtimi i Infrastrukturës në Bll. Nr.61,Rr. "Q. Stafa"		5,000,000
	Rikonstruksion i unazes egzistuese		5,000,000
b	Njësia e menaxhimit te projekteve		
	Projekti "Ndërtimi i banesave me qëllim social"		
	Kosto lokale		10,000,000
	Programi i Shërbimeve Publike Vendore		50,000,000
I	Gr.00 Tit.06260 Kap.5 Art.231		
a	Njësia e Menaxhimit të Projekteve		
	Rigjallerimi i Sheshit "Skenderbej" Faza I		
	Pagesë TVSH-je - Punime civile		5,000,000
	Rigjallerimi i Sheshit "Skenderbej" Faza II		
	Pagesë TVSH-je - Punime civile		10,000,000
	Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi i Lumit te Tiranës		
	Pagesë TVSH-je - Punime Civile Ndërtimi I Bulevardit Verior të Tiranës		20,000,000
	Pagesë TVSH-je -Punimet e Ndërtimit për Rehabilitimin e Lumit të Tiranës dhe Shtratit të tij		10,000,000
	Pagesë TVSH-je - Konsulenca" Projekti I Bulevardit Verior dhe Rigjallerimin e Lumit të Tiranës"		5,000,000

